

VENDIM
Nr. 323, datë 18.5.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR KRIJIMIN, AKSESIN,
FUNKSIONIMIN DHE ADMINISTRIMIN E REGJISTRIT ELEKTRONIK TË
ARMËVE, PJESËVE KRYESORE DHE MUNICIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 10, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e regjistrit elektronik të armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve, në pronësi të personave fizikë dhe juridikë, i cili menaxhohet nga Policia e Shtetit.

2. Regjistri elektronik i armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve, në pronësi të personave fizikë dhe juridikë, krijohet mbi bazën e të dhënave të armëve, pjesëve kryesore të tyre, municioneve, si dhe të dhënave për personat fizikë dhe juridikë, që i kanë ato në pronësi.

3. Regjistri i armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve, në pronësi të personave fizikë dhe juridikë, mbahet në format elektronik në sistem të informatizuar.

4. Regjistri elektronik i armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve në pronësi të personave fizikë dhe juridikë është sipas formatit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Regjistri elektronik i armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve, në pronësi të personave fizikë dhe juridikë, përmban të dhëna për:

a) gjenealogjet e personit fizik ose juridik, që ka në pronësi armën/armët e zjarrit, pjesët kryesore të tyre dhe municionet, përfshirë adresat e furnitorëve, së bashku me datën ose datat përkatëse;

b) armën/armët e zjarrit, pjesët kryesore të tyre dhe municionet, si:

i. llojin, markën, modelin, kalibrin, numrin e serisë së çdo arme zjarri dhe markimin e vendosur në pjesën kryesore për çdo armë zjarri;

ii. numrin e serisë ose markimin unik të vendosur në pjesët kryesore të çdo arme zjarri, në rastin kur ndryshon nga markimi në trupin ose djepin e armës së zjarrit;

c) licencën, autorizimin dhe vendimin për pajisjen me armë zjarri;

ç) dokumentet e pajisjes dhe heqjes së armës së zjarrit;

d) çdo modifikim që i bëhet armës së zjarrit dhe që çon në ndryshimin e kategorisë apo nënkategorisë së saj, duke përfshirë çaktivizimin apo shkatërrimin e certifikuar të saj, si dhe datën ose datat përkatëse;

dh) certifikatën e çaktivizimit.

6. Të dhënat, që administrohen në regjistrin elektronik të armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve, në pronësi të personave fizikë dhe juridikë, mund të aksesohen nga autoritetet kompetente për:

a) lëshimin ose revokimin e autorizimeve e licencave;

b) parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale.

7. Regjistri elektronik i armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve në pronësi të personave fizikë dhe juridikë menaxhohet nga Policia e Shtetit, duke garantuar, si vijon:

a) organet përgjegjëse të Policisë së Shtetit janë subjekte, të cilat plotësojnë të dhënat në regjister, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë;

b) organeve përgjegjëse të Policisë së Shtetit u garantohet akses për leximin e të dhënave, me qëllim përmbushjen e detyrave të tyre;

c) organit të prokurorisë dhe gjykatës u garantohet aksesimi për leximin e të dhënave në regjistrin elektronik të armëve të zjarrit, pjesëve kryesore të tyre dhe municioneve në pronësi të personave fizikë e juridikë. Aksesimi i të dhënave do të mundësohet duke përdorur lidhje VPN (*Virtual Private Network*) me rrjetin e Policisë së Shtetit.

8. Afati i ruajtjes së të dhënave të regjistrit elektronik të armëve të zjarrit, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, në pronësi të personave fizikë e juridikë, është:

a) për lëshimin ose revokimin e autorizimeve e licencave, për një periudhë prej 10 (dhjetë) vjetësh, pas shkatërrimit/çaktivizimit të armës së zjarrit ose pjesëve kryesore;

b) për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale, ose ekzekutimin e dënimeve penale, për një periudhë prej 30 (tridhjetë) vjetësh, pas shkatërrimit/çaktivizimit të armës së zjarrit ose pjesëve kryesore.

9. Vendimi nr. 292, datë 8.4.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e regjistrit të armëve”, shfuqizohet.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

FORMATI I REGJISTRIT ELEKTRONIK TË ARMËVE, PJSËVE KRYESORE DHE MUNICIONEVE

[illegible]